



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 11 qershor 2018
Nr. ref.: VTK 1257/18

VENDIM PËR TËRHEQJE TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI110/17

Parashtrues

Sekule Stanković

Vlerësim i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sekule Stanković nga Medvegja, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Žarko Gajić, avokat nga Graçanica.

Objekti i çështjes

2. Objekti i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe tërheqja e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqja e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 dhe 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 32 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

4. Më 13 shtator 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
5. Më 18 shtator 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përberë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
6. Më 17 tetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi që parashtruesi të paraqiste kopjen e fletëdërgesës me datën e pranimit të vendimit të kontestuar.
7. Më 7 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti kopjen e fletëdërgesës me datën e pranimit të vendimit të kontestuar të 17 majit 2017. Me këtë shkresë, parashtruesi gjithashtu dorëzoi kërkesë në Gjykatë për vendosjen e masës së përkohshme.
8. Më 4 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë. Me këtë shkresë, parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore me rastin e vendosjes për këtë lëndë.
9. Më 23 prill 2018, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij i autorizuar ligjor (Žarko Gajić) iu drejtua Gjykatës me kërkesë për të tërhequr kërkesën.
10. Më 24 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës ta aprovon kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 13 shtator 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (Rev. nr. 233/2014) të Gjykatës Supreme, të 3 shtatorit 2014.
12. Më 24 prill 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesë për tërheqjen e kërkesës së tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore. Parashtruesi i kërkesës në shkresën e tij, ndër të tjera, theksoi:

“[...] Pas parashtrimit të kërkesës, me shikimin në ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë, u konstatua se në këtë çështje juridike tani më është vendosur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI176/14.

Në këtë mënyrë, përfaqësuesi, avokati Žarko Gajić e informon Gjykatën për tërheqjen e kërkesës së dorëzuar për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor sipas revizionit dhe i propozon Gjykatës që ta njoftoj për pezullimin e procedurën në adresën e zyrës në Graçanicë”.

Vlerësimi i kërkesës për tërheqjen e kërkesës

13. Për të vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e punës.
14. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, paraqiti në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur.
15. Më 24 prill 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën për tërheqjen e kërkesës së tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014.
16. Gjykata i referohet nenit 23 [Tërheqja e palës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që iu janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura”.

17. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të. [...]”.

18. Duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit dhe rrethanat e rastit, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për të vazhduar shqyrtimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, si dhe kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.
19. Rrjedhimisht, Gjykata në bazë të rregullit 32 (1) vendos ta aprovon kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32 (1) të Rregullores së punës, më 24 maj 2018,

VENDOS

- I. TA MIRATOJË kërkesën për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë, duke përfshirë edhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për seancën dëgjimore;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi